

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-143/15

**Prishtinë
14 Shkurt 2018**

Në çështjen juridike të:

B. J.

Përfaqësuar nga

Z. J.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Ragip Namani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), KPCC/D/A/244/2014, të datës 18 qershor 2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA42230), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 14 Shkurt, mori këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e B. J. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 të datës 18 qershor 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numrin KPA42230, hedhet poshtë si e paafatshme.

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Më 18 shtator 2007, Z. J, ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) në emër të babait të tij B. J. (në tekstin e mëtejme “pala ankuese”) me të cilën ka kërkuar ri-posedimin e ngastrës nr. 679/29 e cila gjendet në vendin e quajtur “Zvana Cesta” në Lipjan, me sipërfaqe totale prej 1.20.00 ha (në tekstin e mëtejme “prona e kërkuar”). Pala ankuese ka deklaruar se babai i tij ka qenë pronar i pronës së kërkuar dhe se humbja e posedimit lidhet me konfliktin e armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë më 1998/99, duke e përmendur datën 16 qershor 1999 si datë kur është humbur posedimi
2. Në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së dokumentet në vijim:
 - Kopjen e kontratës së shitblerjes së pronës së paluajtshme të lidhur më 1 nëntor 1956 në Lipjan midis L. L. si shitës dhe B. I. si blerës i ngastrës nr. 679/29, të përshkruar në Fletën Poseduese nr. 100, e cila gjendet në fshatin Sllovi, Lipjan, me sipërfaqe totale prej 1.20 ha. Nënshkrimet e palëve kontraktuese janë vërtetuar më 1 nëntor 1956 pranë Gjykatës Komunale në Lipjan me numër të referencës 602/56;
 - Kopjen e certifikatës së lindjes së djalit të palës ankuese, nr. 200-2863/02-IV të lëshuar në Nish më 27 qershor 2002;
 - Kopjen e letërnjoftimit të Z. J.
3. Ekipi i njoftimit i AKP-së ka bërë përpjekje që ta bëjë identifikim e pronës më 7 prill 2008, por pa sukses. Sipas raportit të njoftimit, prona e kërkuar është gjetur të jetë tokë e kultivuar e uzurpuar nga personi i panjohur. Ekipi i Notifikimit ka bërë përpjekje për ta identifikuar personin i cili e shfrytëzon atë, por pa sukses. Prandaj, më 22 korrik 2010 njoftimi i kërkesës është bërë përmes publikimit në Gazetën zyrtare të AKP-së nr. 5 në buletinin e Zyrës për pronë të UNHCR-së. Gazeta dhe lista i janë lënë kryetarit të fshatit i cili është pajtuar që t’ua vë në dispozicion palëve të interesuara. Njoftimet e njëjta janë vendosur në hyrjen dhe daljen e fshatit Sllovi, Komunën e Lipjanit, Zyrën Kadastrale në Lipjan, Zyrën Regjionale në Prishtinë. Përveç kësaj, lista dhe gazeta janë shpërndarë në Zyrën kryesore të UNHCR-së, Avokatit të Popullit, Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK), the Këshillin Danez të Refugjatëve (KDR) dhe Zyrën e UNMIK-ut në Graçanicë.

4. Pasi që asnjë palë nuk ka paraqitur përgjigje ndaj kërkesës brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079 kërkesa është konsideruar jo kontestuese
5. Sipas raportit të verifikimit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, kontrata e shitblerjes nr. 602/56 e lidhur më 1 nëntor 1956 është verifikuar pozitivisht, ndërsa ngastra kadastrale nr. 679/29 nuk është gjetur si e tillë më parë në kadastrin kompetent. Në vend të kësaj, ngastra kadastrale nr. 679 (e pandarë) është gjetur e regjistruar në emër të O.K. i cili ka qenë pronar i pronës së kërkuar prej vitit 1986, dhe përsëri ai paraqitet si pronar i pronës së kërkuar. Raportit të verifikimit i është bashkangjitur certifikata mbi të drejtat e paluajtshme nr. 71409077-00679 e lëshuar nga Zyra e Kadastrit e Komunës së Lipjanit më 3 nëntor 2010, në të cilën ngastra kadastrale nr. 679 me sipërfaqe prej 00.51.13 ha figuron e regjistruar në emër të O.K. KANU.
6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e ka kontaktuar palën ankuese dhe i ka kërkuar që të paraqesë dokumente plotësuese për ta vërtetuar të drejtën e pretenduar pronësore të babait të tij mbi pronën e kërkuar pasi që dokumentet e dorëzuara tashmë nuk e vërtetojnë mjaftueshëm këtë rrethanë
7. Për më tepër, më 15 janar 2013, palës ankuese i është dërguar një njoftim zyrtar duke e njoftuar atë se nëse nuk i paraqet dokumentet e kërkuara brenda afatit të caktuar, kërkesa e tij mund të refuzohet nga Komisioni (faqe nr. 136 e shkresave të lëndës).
8. Pala ankuese nuk i ka paraqitur dokumentet e kërkuara
9. Me vendimin numër KPCC/D/A/244/2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme “KPKK”) ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës nuk e ka vërtetuar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
10. Më 20 tetor 2014, vendimi i KPKK-së i është dorëzuar palës ankuese. Më 21 nëntor 2014, pala ankuese ka paraqitur ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese e ka pranuar se kishte dështuar që t’ia dorëzojë Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së dokumentet e kërkuara. Ai nënvizoi se prona e kërkuar i përkiste familjes së tij dhe se familja e tij nuk e ka shitur atë. Për më tepër, ai tregoi se ankesa kishte të bënte me lokacionin e pronës së kërkuar.

Arsyetimi ligjor

12. Ankesa është e paafatshme. Neni 12.1i ligjit nr. 03/L-079 “Mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale” (në tekstin e mëtejme “Ligji nr. 03/L-079”) përcakton si në vijim: “*Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës*”.

13. Pala ankuese e ka pranuar personalisht vendimin e KKKPK-së më 20 tetor; prandaj afati për të paraqitur ankesë ka skaduar më 19 nëntor 2014, pasi që dita e 30-të ka qenë ditë pune. Sidoqoftë, pala ankuese ka paraqitur ankesë vetëm më 21 nëntor 2014, dy ditë pas skadimit të afatit. Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj.
14. Gjykata ka gjetur se dorëzimi është bërë personalisht në përputhje me nenin 110.1 të Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008). Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë arsye për vonesën në paraqitjen e ankesës, dhe as gjykata nuk ka gjetur asnjë arsye për vonesën në shkresat e lëndës
15. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e papranueshme në bazë të arsyeve procedurale të ligjit të lartpërmendur. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtoj arsyet e ankesës.
16. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafin 1(a) të Ligjit për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme.

Beshir Islami, kryetar i kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Ragip Namani, gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam , referent i EULEX-it